

Република Северна Македонија

Министерство за труд
и социјална политика



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Punës
dhe Politikës Sociale

Në bazë të nenit 157 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 104/19, 146/19 dhe 275/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22 dhe 236/2022), Komisioni për sigurimin e mjeteve për shërbime sociale nga komunat dhe ofruesit e tjerë, i formuar nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale publikon

KONKURS PUBLIK

për ndarjen e mjeteve për shoqatat dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve sociale

1. Lloji i shërbimit:

Me këtë Konkurs publik sigurohen mjete për shoqatat e qytetarëve dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale për sigurimin e këtyre shërbimeve:

Shërbim për mbrojtje jashtë familjes

- Jetesë me mbështetje, me të cilën sigurohet jetesë e pavarur e shfrytëzuesve të njësisë banesore me mbështetje nga ana e personave profesionalë ose personave tjerë në realizimin e aktiviteteve themelore dhe instrumentale në jetën e përditshme, dhe

2. Shuma e mjeteve për shfrytëzues që ndahen dhe periudha kohore në të cilën do të kryhen punët

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të sigurojë mbështetje financiare për zbatimin e shërbimeve sociale në përputhje me kapacitetin e përcaktuar të ofruesve të licencuar të shërbimeve, në përputhje me koston e shërbimeve për një shfrytëzues përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në Ent, për qëndrim ditor, për mbrojtje sociale jashtë familjare dhe për mbështetje dhe ndihmë profesionale për vitin 2023, miratuar nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, nr. 10-8807/1 i dt. 15.12.2022 i përpiluar në përputhje me Metodologjinë për formimin e çmimeve të shërbimeve varësisht nga normativat dhe standardet për ofrimin e shërbimit social (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 264/19) në bazë mujore, në periudhën prej lidhjes së Marrëveshjes së bordit me ofruesin e licencuar të shërbimit deri më 31.12.2023 edhe atë:

Për shërbimin jetesë me mbështetje

- 22.064 denarë në muaj për jetesë me mbështetje të herëpashershme të organizuar për personat me aftësi të kufizuara, respektivisht 723 denarë në ditë për një shfrytëzues.
- 30.472 denarë në muaj për jetesë me mbështetje të vazhdueshme 8 orë të personit me aftësi të kufizuara, respektivisht 999 denarë në ditë për një shfrytëzues.
- 38.177 denarë në muaj për mbështetje të vazhdueshme 24 orë për persona me aftësi të kufizuara, respektivisht 1.252 denarë në ditë për një shfrytëzues.

3. Dokumentet e nevojshme

Parashtruesi i dorëzon këto dokumente:

1. Fletëparaqitje;
2. Raport vjetor për punën e shoqatës për vitin paraprak
3. Vërtetim për tatimet e paguara, e lëshuar nga organet tatimore jo më të vjetër se gjashtë muaj
4. Deklaratë të vulosur te noteri se nuk ka marrë mjete nga ndonjë organ tjetër shtetëror ose njësi të vetëqeverisjes lokale për shërbimin e njëjtë, dhe
5. Vendim për dhënien e lejes për kryerjen e punëve në mbrojtjes sociale.

Dokumentet nga pikët 3 dhe 4 dorëzohen në origjinal ose kopje të noterizuar te noteri.

4. Në fletëparaqitjen e shoqatës respektivisht ofruesit tjetër privat të shërbimit social që ka leje për kryerjen e punës nga mbrojtja sociale, shënohen këtë të dhëna:

- 1) Emri i plotë dhe adresa e subjekteve me aktivitete të definuara qartë gjatë realizimit të programit për ofrimin e shërbimeve sociale për të cilin kërkon ndarjen e mjeteve,
- 2) Përshkrim detal i aktiviteteve me plan konkret pune për implementim dhe periudha e realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social, me të cilat do të sigurohet realizimi i qëllimeve të parashikuara, aktiviteteve dhe shërbimeve të definuara në konkursin publik me mjetet e parashikuara,
- 3) Kuadri profesional dhe tjetër dhe biografia e secilit personal që do të angazhohet për ofrimin e shërbimit social;
- 4) Kontakti me personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit për ofrimin e shërbimit social (emri, mbiemri, e-mail dhe numri i telefonit)
- 5) Përvoja e punës në sferën e mbrojtjes sociale, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e konkursit publik, partneritetit të realizuar, bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëfinancimit të siguar (nëse ka) dhe
- 6) Mekanizmi i vendosur për kontrollin e cilësisë dhe sistemin e ankesave nga klientët.

5. Afatet për zbatimin e procedurës

Konkursi zgjatë pesë ditë pune duke llogaritur nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Shoqatat e interesuara të qytetarëve dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale fletëparaqitjet mund t'i dorëzojnë më së voni deri në orën 16 në ditën e fundit të afatit të zgjatjes së konkursit, respektivisht deri në orën 9 ditën e ardhshme nëse dita e fundit e konkursit bie në ditë jopune, përmes Arkivit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, në adresën rr. Dame Gruev, nr. 14 Shkup, në zarf të mbyllur me shënim: Për konkursin publik për sigurimin e mjeteve për shërbimet sociale.

Fletëparaqitjet që do të dërgohen pas këtij afati dhe me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për sigurimin e mjeteve në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve përgatitë mendim tek ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, pas marrjes së mendimit nga Komisioni për sigurimin e mjeteve, sjell vendim për ndarjen e mjeteve.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale do të lidhë kontratë administrative me të cilën do të përcaktohen të drejtat e ndërsjella dhe përgjegjësitë në realizimin e mjeteve të ndara, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për ndarjen e mjeteve.

Shoqatat ose ofruesit privatë të shërbimeve sociale që do të marrin mjete nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kanë për obligim që në të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike), që do të prodhohen në kuadër të këtij shërbimi, në vend të dukshëm të vendosin:

Përkrahur nga:

Republika e Maqedonisë së Veriut
MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE